



Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



100 Vjet Shtet Shqiptar



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr. 7946 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.1, 40 (të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008), Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 2.3, Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovë Nr.04/L-079 për vitin 2012 neni 7 dhe në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndarje buxhetore Nr.04/101, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 22.11.2012 mori:

## VENDIM

### PËR

### SHPËRNDARJEN E MJETEVE BUXHETORE PËR VITIN 2012

#### I

Miratohet propozim vendimi për shpërndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 100.000 € të cilat janë dedikuar për komunën e Hanit të Elezit, nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

#### II

Shpërndarja e këtyre mjeteve bëhet në këto kategori ekonomike: mallra dhe shërbime, në shumë prej 82.000 €, në shpenzime komunale në shumë prej 8.000€, dhe në subvencione dhe transfero në shume prej 10.000 €

#### III

Nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 82.000 €. shpërndahet në këto programe buxhetore, Zyra e Kryetarit (160) nën-programi (16035) në shumën prej 15.000€, në programin buxhetor Administrata dhe Personeli (163) nën-programi (16335) në shumën prej 15.000 €. në programin Shëndetësi dhe Mirëqenia Sociale (730) nën-programi (73044) në shumën prej 20.000 € dhe në programin Arsimi dhe Shkenca në shumë prej 32.000 €.

#### IV

Nga kategoria ekonomike shpenzime komunale shuma prej 8.000 € shpërndahet në këto programe buxhetore: në programin Administrata dhe Personeli, kodi 163/16335 në shumë prej 7.000 €, në programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale, kodi 730/73044 në shumë prej 1.000 €.

**V**

Kategoria Subvencione dhe Transfere shuma prej 10.000 € shpërndahet në programin: zyra e kryetarit, kodi 160/16035 në shumë prej 10,000€

**VI**

Ekzekutimin e këtij vendimi do ta bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**VII**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

**VIII**

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave - Departamenti i Buxheteve Komunale dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data: 22.11.2012

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlasi

